


INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr.No.Br. 2/64
Dt. 30.07.2026
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje



Infrakos

**PLANI I RISHIKUAR I
BIZNESIT
2026**

Parathënie

Rrjeti hekurudhor i Kosovës, i menaxhuar nga INFRAKOS, përmes të cilit transportohet një numër i konsiderueshëm udhëtarësh dhe mallrash në mënyrë të sigurt dhe efikase, edhe pse ka qenë dhe vazhdon të jetë në proces rehabilitimi, ka ofruar shërbimet e parapara me Ekspozenë e Rrjetit Hekurudhor dhe legjislacionin në fuqi. Krahas ofrimit të shërbimeve për operatorët hekurudhorë TRAINKOS dhe RAILTRANS, kompani ka qenë e angazhuar maksimalisht edhe në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të patundshmërive dhe shërbimeve të tjera për klientët e saj.

Si rezultat i këtyre angazhimeve, kënaqësia e klientëve ka mbetur në nivele relativisht të larta. Gjatë vitit 2026, fokusi kryesor do të vazhdojë të jetë ulja e shpenzimeve, zvogëlimi i detyrimeve financiare dhe rritja e nivelit të inkasimit, prioritete që do të mbeten në qendër të veprimtarisë edhe në periudhën vijuese.

Ky pozicionim reflekton njëkohësisht sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet ndërmarrja. Objektivi ynë mbetet rritja e vazhdueshme e kënaqësisë së konsumatorëve, duke përmbushur kërkesat gjithnjë në rritje dhe duke ruajtur balancën ndërmjet kapaciteteve, performancës dhe kostos. Për këtë arsye, do të vazhdojmë të punojmë me efikasitet më të lartë drejt modernizimit të rrjetit hekurudhor dhe sigurimit të qëndrueshmërisë financiare të kompanisë, një objektivi që për shumë vite ka mbetur sfidë.

Plani i Biznesit i rishikuar për vitin 2026, i hartuar nga INFRAKOS, synon të realizohet në tërësi, pavarësisht sfidave të konsiderueshme në sektorin e transportit hekurudhor, të shkaktuara nga punimet në Linjën Hekurudhore 10. Plani i Biznesit për vitin 2026 ka karakter zhvillimor dhe synon të vendosë themelet e një ndërmarrjeje moderne dhe financiarisht të qëndrueshme. Edhe pse sfidat mbeten të mëdha dhe mundësitë që ofron sektori hekurudhor janë ende të kufizuara, ne besojmë se ky plan do të realizohet në tërësi. Zbatimi i tij do të mundësojë zhvillimin e rrjetit hekurudhor në përputhje me realitetin ekzistues, duke ndjekur një qasje realiste dhe të qëndrueshme. Për realizimin e këtij vizioni është e domosdoshme mbështetja më e madhe e institucioneve përgjegjëse në zbatimin e projekteve zhvillimore, të cilat janë në interes të drejtpërdrejtë të vendit.

Rrjeti hekurudhor ekziston për të krijuar vlerë të shtuar për qytetarët, taksapaguesit dhe përdoruesit e shërbimeve. Kjo kërkon identifikim të saktë të kapaciteteve financiare të kompanisë, si dhe orientim të qartë të politikave dhe investimeve afatgjata në infrastrukturën hekurudhore. Në këtë funksion, Plani i Biznesit paraqet gjendjen aktuale të aseteve, pozitën financiare të kompanisë dhe planin për realizimin e projekteve infrastrukturore me rëndësi strategjike.

Për shkak të mungesës së investimeve ndër vite në rehabilitimin e infrastrukturës, gjendja e rrjetit hekurudhor të INFRAKOS-it vazhdon të kërkojë investime të konsiderueshme për përmirësimin dhe funksionalizimin e tij të plotë. Me mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, granteve të Bashkimit Evropian, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), do të vazhdojë zbatimi i projekteve zhvillimore edhe gjatë vitit 2026. Në këtë kuadër pritet të vazhdojë rehabilitimi i linjave hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit, Fushë Kosovë – Mitrovicë dhe Mitrovicë – Leshak, duke mundur

modernizimin e tyre si pjesë e rrjetit të zgjeruar evropian TEN-T. Viti 2026 pritet të jetë vit i investimeve intensive dhe punimeve të mëdha drejt rehabilitimit të përgjithshëm të Linjës Hekurudhore 10, e cila, pas përfundimit të punimeve, do të përmbushë standardet evropiane dhe do të krijojë parakushtet për zhvillimin e sektorit hekurudhor në Kosovë, duke e lidhur atë më fuqishëm me rrjetin rajonal dhe atë evropian.

Për realizimin me sukses të objektivave, planifikohen ndryshime të rëndësishme në organizimin e punës, duke rritur përgjegjësinë dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e kompanisë. Njëkohësisht, mbetet e domosdoshme që në koordinim me institucionet përgjegjëse të përcaktohet mënyra financimit dhe subvencionimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një qasje e tillë do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operative dhe performancës së kompanisë, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve me cilësi më të lartë dhe vlerë më të madhe për taksapaguesit dhe klientët.

Për të arritur këto synime, është thelbësore të fitojmë dhe të ruajmë besimin e të gjitha palëve të interesit përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe të sigurt në rrjetin hekurudhor. INFRAKOS synon të zhvillojë zgjidhje inovative dhe efikase, duke eksploruar vazhdimisht mënyra të reja të organizimit të punës, me qëllim rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe të ardhurave. Kjo do të krijojë bazën për një kompani të qëndrueshme, konkurruese dhe të suksesshme në afat të gjatë.

Plani i rishikuar i biznesit për vitin 2026 është hartuar në përputhje me Planin Strategjik Afatmesëm të Biznesit 2025–2027 dhe kapaciteteve dhe nevojave aktuale të ndërmarrjes. Ky plan paraqet një dokument që siguron qëndrueshmëri, likuiditet dhe krijon parakushte për zhvillim. Përcakton qartë objektivat dhe detyrat që kompania duhet të realizojë për të siguruar një rrjet hekurudhor të sigurt dhe funksional, duke ofruar shërbime gjithnjë e më cilësore për operatorët dhe përdoruesit e saj. Njëkohësisht, krijon bazën për transformimin e kompanisë në një organizatë me vizion afatgjatë dhe me kapacitete të mjaftueshme për të udhëhequr zhvillimin e sistemit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Kryeshefi Ekzekutiv!

Bujar JUPAJ

Përmbajtja

Kapitulli	Përmbajtja e kapitullit	Faqe
Deklarata E drejtimit strategjik	Ky kapitull prezanton rolin, qëllimin dhe vizionin tonë, në kontekstin e një vizioni afatgjatë për rrjetin hekurudhor dhe shërbimet të cilat i ofron INFRAKOS-i	05-11
Transformimi i rrjetit hekurudhor	Ky kapitull përcakton temat strategjike, rezultatet e tyre dhe nismat kryesore të cilat do të transformojnë kompaninë dhe do të shpërndajnë vizionin tonë për kompaninë dhe industrinë	13-19
Planet e të hyrave dhe shpenzimeve	Ky kapitull përcakton parashikimet tona të aktiviteteve rreth të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën kohore (janar - dhjetor) 2025	21-27
Rezultatet	Ky kapitull përcakton parashikimet e rezultateve të cilat planifikojmë t'i realizojmë për periudhën kohore (janar - dhjetor) 2025	29-31
Shpërndarja, rreziqet dhe supozimet	Ky kapitull përcakton vlerësimin tonë të shpërndarjes së planit, supozimet kyçe të cilat ne i kemi bërë, si dhe analizat e nivelit të rrezikut dhe pasigurisë që i rrethojnë parashikimet tona	33-35
Struktura, kapacitetet njerëzore	Ky kapitull përcakton kornizën e strukturës organizative dhe nevojat e kompanisë për resurset njerëzore për realizimin e planit të biznesit	37-39
Hapat e ardhshëm	Ky kapitull përcakton zhvillimin e mëtejshëm të planeve tona dhe hapat e ardhshëm të zhvillimit të kompanisë	40



Deklarata e drejtimit strategjik

<i>Çka dëshirojmë të arrimë - Vizioni</i>	05
<i>Si dëshirojmë ta arrimë - Misioni</i>	05
<i>Vlerat dhe parimet</i>	05
<i>Historiku dhe performanca në të ardhmen</i>	05
<i>Ambienti dhe ndikimi në zhvillimet hekurudhore</i>	06
<i>Reflektimi i mundësive në PB</i>	07
<i>Objektivat e kompanisë për rrjetin hekurudhor</i>	07
<i>Potenciali i stafit tonë për realizimin e vizionit</i>	09
<i>Definimi i kërkesave për arritjen e vizionit</i>	10
<i>Raportimi</i>	11

Vizioni

Të jemi prijës në ofrimin e traseve hekurudhore dhe shërbimeve tjera të infrastrukturës për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të barabartë, transparente dhe jo diskriminuese. Të jemi ofrues tërheqës dhe më i efektshëm i rrjetit hekurudhor në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Misioni

Krijimi i një rrjeti hekurudhor konkurrues, të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në përputhje me nevojat e shoqërisë, ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, si dhe duke i plotësuar kërkesat e sigurisë, të ambientit dhe ato ekonomike.

Vlerat dhe parimet

INFRAKOS-i si e vetmja kompani përgjegjëse në Kosovë për menaxhimin me infrastrukturën hekurudhore do t'i përmbahet vlerave dhe parimeve vijuese:

- ➔ Ofrimin e traseve hekurudhore për të gjithë operatorët hekurudhor sipas kornizës ligjore ekzistuese dhe parimeve të korrektësisë, barazisë dhe jo diskriminimit;
- ➔ Ofrimin e të gjitha shërbimeve tjera të infrastrukturës për të gjithë operatorët hekurudhor në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese;
- ➔ Ofrimin të favorshëm dhe të barabartë të patundshmërisë tonë me qira për të gjithë klientët ekzistues dhe ata të cilët dëshirojnë ta shfrytëzojnë pronën tonë në të ardhmen;
- ➔ Ofrimin të sigurisë maksimale për të gjithë qarkullimin e trenave të udhëtarëve dhe mallrave në tërë rrjetin hekurudhor;
- ➔ Bashkëpunimin e lartë me tërë komunitetin, institucionet qeveritare dhe komunale për ofrimin sa më të mirë të shërbimeve dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Historiku dhe përformanca në të ardhmen

INFRAKOS-i e ka në menaxhim rrjetin hekurudhor të Kosovës i cili shtrihet në tërë territorin e republikës me një gjatësi prej rreth 335 kilometrave. Që nga fillimi i ndërtimit të linjës së parë hekurudhore në vitin 1874 e deri më sot, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ka kaluar nëpër shumë sfida, qoftë sa i përket mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sajë, qoftë sa i përket eksplotimit të linjave hekurudhore.

Gjatë vitit 2025, INFRAKOS-I ka pasur në shfrytëzim vetëm Linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardh – Medvec, ndërsa linjat Prishtinë – Podujevë, Klinë – Prizren dhe Leshak - Mitrovicë kanë qenë jashtë operimit. Linja Mitrovicë – Hani Elezit ka qenë jashtë operimit për shkak të rehabilitimit të saj.

Pjesa veriore e Linjës së dhjetë hekurudhore Leshak – Mitrovicë ka qenë jashtë funksionit për arsye politike të cilat janë të ndërlidhura me veriun e Kosovës, pjesa Prishtinë – Podujevë për shkak të dëmtimeve tejet të mëdha të kësaj linje dhe pamundësisë së rehabilitimit të sajë, ndërsa ngjashëm qëndron situata edhe sa i përket linjës hekurudhore Klinë – Prizren.

RAILWAY NETWORK OF KOSOVO



Falë angazhimeve të të gjithë stafit, siguria e qarkullimit të trenave dhe e të gjitha mjeteve tjera lëvizëse gjatë vitit 2025 ka qenë në nivelin maksimal. Kjo ka kërkuar angazhimet tona shtesë, sidomos duke pasur parasysh mungesën e mjaftueshme të mjeteve financiare për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.

Gjatë vitit 2026 INFRAKOS-i parasheh ndryshime të konsiderueshme sa i përket rehabilitimit të linjave ekzistuese hekurudhore siç është përfundimi i rehabilitimit gjeneral të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit dhe Fushë Kosovë-Mitrovicë) pjesa civile. Segmenti hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit është prit të përfundojë deri në shtator 2024, prandaj deri në atë kohë kjo linjë hekurudhore do të jetë e hapur për qarkullim të trenave në orare të caktuara. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore Kosovë – Shqipëri pritet të fillon, pasi që është bërë studimi i fizibilitetit, e që do të përfshihen linjat hekurudhore Fushë Kosovë – Klinë - Pejë dhe Klinë – Prizren.

Ndërsa sa i përket performancës, kompania do të angazhohet maksimalisht në përmirësimin e të gjitha shërbimeve, ashtu që klientët tanë të jenë të kënaqur me ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ambienti dhe ndikimi në zhvillimet e infrastrukturës hekurudhore

Hekurudha, respektivisht infrastruktura hekurudhore paraqet një industri e cila ofron shërbime për tregje të ndryshme dhe klientë të ndryshëm. Të gjithë këta presin që të ofrohen shërbime sa më të mira dhe me një çmim sa më të vogël. Andaj, që të arrihet ky qëllim, nevojiten politika dhe strategji të qarta zhvillimore të kompanisë, respektivisht

mbështetja e pa rezervë e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me një fjalë, Qeveria e Kosovës duhet që të krijojë politika dhe strategji të mirëfillta për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore, ashtu që kjo infrastrukturë të ofrojë kushte, cilësi, kapacitet dhe siguri maksimale sa i përket traseve hekurudhore dhe shërbimeve tjera të infrastrukturës.

Që të arrihet një ambient i tillë, nevojitet që politikat Qeveritare të jenë të orientuara drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore, ndërsa politikat tona do të jenë të orientuara drejt ofrimit maksimal të shërbimeve të duhura, duke u mbështetur në parimin e korrektesisë dhe transparencës me publikun, ashtu siç e kemi bërë edhe në vitet paraprake.

Reflektimi i mundësive në Planin e Biznesit

Mundësitë për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore janë të mëdha. INFRAKOS-i ka hartuar këtë Plan të Biznesit duke u bazuar në nevojat reale të kompanisë dhe realitetin e krijuar për zhvillimin e infrastrukturës. Ky plan përcakton në mënyrë të qartë nevojën e kompanisë dhe mundësitë e investimeve ashtu që të realizohen investimet e planifikuara në drejtim të mirëmbajtjes dhe ofrimit sa më të mirë të shërbimeve të infrastrukturës.

INFRAKOS-i nuk kërkon as më pak dhe as më shumë se sa realizimin e investimeve dhe subvencionimit të paraparë me strategjinë zhvillimore të sektorit hekurudhor dhe Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës.

Për këtë, qëllimi i jonë është që në këtë Plan të Biznesit të bëhet përcaktimi i qartë i nevojave, kërkesave tona dhe mundësisë së realizimit të këtyre kërkesave për tërë vitin 2026.

Objektivat e kompanisë për rrjetin hekurudhor

Më lartë është përshkruar Vizioni dhe Misioni i INFRAKOS-it për vitin 2026. Për realizimin e këtij Vizioni dhe Misioni, INFRAKOS-i ka përcaktuar disa objektiva tejte të qarta të cilat duhet të realizohen këtë vit dhe pa realizimin e të cilave nuk do të ketë zhvillim të mirëfilltë të infrastrukturës hekurudhore.

Prandaj, në mënyrë që të bëhet zhvillimi i mirëfilltë i infrastrukturës hekurudhore në vitin 2025, INFRAKOS-i ka paraparë realizimin e objektivave vijuese:

<i>Qëllimi, pse ne ekzistojmë?</i>	Qëllimi kryesor i ekzistimit të INFRAKOS-it ndërlidhet me mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore, ashtu që kjo infrastrukturë të garanton qarkullimin e sigurt të trenave të udhëtarëve dhe mallrave. INFRAKOS-i po ashtu bënë realizimin e obligimeve të cilat dalin nga kërkesa e taksapaguesve të Kosovës, respektivisht institucioneve përkatëse qeveritare në emër të tyre.
<i>Roli i jonë</i>	Roli i kompanisë tonë është kyç në zhvillimin e transportit hekurudhor, ofrimin e shërbimeve për të gjithë operatorët hekurudhor dhe klientët tjerë duke qenë si liderë të cilët ndikojnë në mbrojtjen e ambientit, reduktimin e fluksit të automjeteve në rrugët e Kosovës, zvogëlimin e aksidenteve, mbrojtjes së ambientit dhe çka është më e rëndësishme ofrimin e mundësive për transporte me kapacitete të mëdha.
<i>Çka dëshirojmë të bëjmë?</i>	Vitin 2026 e kemi quajtur si vitin e ndryshimeve dhe për këtë kemi përcaktuar objektiva të qarta të cilat do të mundësojnë zhvillimin më të hovshëm të kompanisë. Ndër objektivat e shumta do të përmendim këto: 1. Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin më të lartë të mundshëm konform rregullativave dhe legjislacionit në fuqi. 2. Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit. 3. Angazhimi maksimal në menaxhimin e mirë të resurseve ekzistuese për realizimin e të hyrave të parapara. 4. Ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor në mënyrë korrekte, transparente dhe jo diskriminuese. 5. Menaxhimi i mirëfilltë i patundshmërisë si resursi i dytë i krijimit të të hyrave dhe eliminimi i borxheve të këqija. 6. Përfundimin e Projekt Dizajnit për rehabilitimin dhe modernizimin e fazës së tretë të linjës 10 hekurudhore (Mitrovicë-Leshak) përfshirë sinjalizimin dhe telekomunikimin.

	7. Përfundimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së parë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), në të dy fazat punuese. 8. Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së tretë të Linjës së 10 hekurudhore (Mitrovicë – Leshak). 9. Zbatimi i procedurave për rehabilitimin e pajisjeve sinjalo siguroese dhe të energjetikës për fazën e parë dhe të dytë (Mitrovicë – Hani i Elezit). 10. Hartimi i dizajnit preliminar për Linjën Hekurudhore (Klinë – Prizren) dhe Linjën Hekurudhore (Fushë Kosovë - Klinë – Pejë). 11. Ngritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë.
<i>Si do t'i realizojmë ndryshimet?</i>	INFRAKOS-i është në dijeni të sfidave të cilat e presin për realizimin e objektivave të parapara. Politika e jonë ka qenë dhe mbetet e tillë që prioriteti numër një në realizimin e objektivave të parapara duhet të jetë angazhimi i menaxhmentit të kompanisë dhe i tërë stafit tjetër ekzekutiv. Ne jemi të vetëdijshëm për sfidat, andaj për vitin 2026 do të shtojmë angazhimet tona për një qasje krejtësisht tjetër ndaj përgjegjësive tona drejt institucioneve përgjegjëse dhe publikut. Ne jemi duke bërë dhe do të bëjmë një punë shtesë në bindjen e institucioneve shtetërore dhe institucioneve tjera ndërkombëtare se investimi në rrjetin hekurudhor, është dhe duhet të jetë prioriteti numër një.


Potenciali i stafit tonë për realizimin e vizionit

INFRAKOS-i e ka një traditë dhe eksperiencë të madhe (të ripërtërirë nëpër vite) për realizimin e detyrave të parapara dhe një staf kompetent (të vetëdijshëm dhe të zot) i cili i ka përcaktuar me kohë obligimet dhe detyrat e veta, afatet e realizimit të këtyre detyrave dhe mënyrën se si do të veprohet, ashtu që suksesi në vitin 2026 të jetë i garantuar.

Në politikat e burimeve njerëzore punohet që të kemi planifikime të qarta, të matshme dhe të arritshme dhe përfshinë komponentë që nga shkollimi, trajnimi e deri të

ripërtëritja e stafit në mënyrë që të përmbushim përgjegjësitë e parapara dhe realizimit të suksesshëm të tyre edhe në vitin 2026 dhe periudhën vijuese. Marrë parasysh gjendjen financiare dhe kompleksitetin dhe specifikat profesionale që kërkohen nga veprimtaria hekurudhore, kjo për ne paraqet një sfidë relativisht të madhe, por e realizueshme me politika të analizuara dhe projektuar

Pra, çdo veprimi i yni për realizimin e objektivave të parashtruara më lartë është i ndërlidhur me mjetet financiare të cilat duhet të sigurohen nga Qeveria pasi që është nënshkruar marrëveshjen financiare pesëvjeçare me INFRAKOS-in.



Definimi i kërkesave për arritjen e vizionit

Duke dashur që të mos kemi ngecje eventuale në realizimin e vizionit tonë për vitin 2026, ne kemi përcaktuar dhe definuar të gjitha kërkesat tona, ashtu që ky Plan i Biznesit të realizohet me sukses, me çka do të bëhej edhe realizimi i vizionit tonë për hekurudhën.

Për këtë, Menaxhmenti i INFRAKOS-it së bashku me Bordin e Drejtorëve i ka definuar saktë të gjitha kërkesat të cilat pritet të fillojnë të realizohen gjatë tërë vitit 2026, ashtu që kompania e jonë të arrin nivelet e duhura për çështjet vijuese:

Siguria	INFRAKOS-i do të punojë maksimalisht në mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe eliminimin e faktorëve të cilët ndikojnë në cenimin e sigurisë hekurudhore. Që kjo të realizohet me sukses, ne i kemi adresuar me kohë kërkesat tona drejt institucioneve qeveritare, ashtu që ato të bëjnë mbështetjen e kërkuar ndaj kompanisë.
Qëndrueshmëria	INFRAKOS-i do të punojë maksimalisht në zbatimin e planeve dhe politikave zhvillimore të kompanisë, duke krijuar kështu një klimë të volitshme për investitorët e ndryshëm dhe një partneritet

	të mirëfilltë, ashtu që të kemi një qëndrueshmëri të nevojshme të kompanisë për operim të sigurt.
Asetet	INFRAKOS-i do të punojë maksimalisht në menaxhimin e mirëfilltë të gjitha asetëve ekzistuese dhe realizimit të planeve strategjike të kompanisë, ashtu që të kemi një qëndrueshmëri të nevojshme të kompanisë si në fushën financiare, ashtu edhe në fushën tekniko – teknologjike.
Performanca	INFRAKOS-i do të punojë maksimalisht në menaxhimin e mirëfilltë të rrjetit hekurudhor, ashtu që të bëhet realizimi i suksesshëm i lëvizjes së trenave sipas traseve të cilat iu kanë dhënë në dispozicion operatorëve hekurudhorë, ndërsa performanca e kompanisë do të jetë gjithnjë në rritje.
Projektet	INFRAKOS-i do të punojë maksimalisht në menaxhimin e mirëfilltë të projekteve të parapara dhe të financuara nga kompania, por një vëmendje të posaçme do ta ketë për projektet e financuara nga Buxheti i Kosovës. Për këtë arsye, kompania e ka bërë me kohë definimin e projekteve zhvillimore duke i propozuar resurset e financimit ashtu që këto projekte zhvillimore të gjejnë rrugën e duhur deri në realizimin e tyre.

Raportimi

INFRAKOS-i e ka të vendosur një praktikë të gjatë të informimit dhe raportimit për të gjitha ndodhitë të cilat janë të ndërlidhura apo kanë ndikim të drejtpërdrejtë në fushat e menaxhimit të kësaj kompanie.


Njëri ndër kompanisë dhe do të informimi i dhe gjendjen

përgatitja



virtetet kryesore të sonë ka qenë, mbetet jetë korrektësia, saktë, transparenca raportimi me kohë për ekzistuese të kompanisë, si dhe e raporteve dhe informatave tjera për institucionet

përgjegjëse konform legjislacionit në fuqi. Bazuar në këtë që u tha më lartë, INFRAKOS-i do të jetë në nivelin e detyrës ashtu që gjatë vitit 2026 të bënë me kohë informimin dhe raportimin e kërkuar me ligj për institucionet përgjegjëse.



<i>Siguria</i>	13
<i>Qëndrueshmëria</i>	13
<i>Menaxhimi i asetëve</i>	14
<i>Kapacitetet dhe menaxhimi i performancës</i>	14
<i>Projektet zhvillimore</i>	15

Siguria

INFRAKOS-i si prioritet numër një ka pasur dhe do të ketë sigurinë e qarkullimit të trenave, respektivisht mirëmbajtjen e stabilimenteve dhe pajisjeve të infrastrukturës ashtu që këto të jenë në nivelin e duhur duke mos e cenuar për asnjë moment sigurinë e lëvizjes. Për punën tonë kemi zbatuar dhe do të zbatojmë të gjitha rregulloret teknike të cilat e përcaktojnë në mënyrë të detajuar, mënyrën e mirëmbajtjes, intervenimit në pengesa dhe kontrollimeve të sistemit të linjave hekurudhore, sistemit të sinjalizimit, telekomunikimit dhe energjetikës, si dhe sistemit të organizimit dhe mbikëqyrjes të komunikacionit hekurudhor.

Ne nuk do të lejojmë që të kemi një infrastrukturë e cila do të rrezikonte sigurinë e lëvizjes së trenave.

Për fat të keq, për arsye të gjendjes jo të mirë financiare dhe mosrealizimit të kërkesave tona për mjete më të mëdha buxhetore, ne shpeshherë ishim të detyruar që intervenimet në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës t'i bëjmë vetëm në rastet emergjente. Një vazhdimësi e gjatë e një gjendje të këtillë do të ishte rrezik potencial për cenimin e sigurisë. Për këtë arsye kërkesa e jonë ndaj qeverisë ka qenë dhe mbetet e njëjtë, që shteti duhet të investojë shumë më shumë në sistemin hekurudhor.

INFRAKOS-i do të mobilizohet me të gjitha potencialet e veta që në vitin 2026 të kemi një cilësi më të lartë të infrastrukturës dhe shërbimeve tjera dhe për këtë do të bëhen përgatitjet e nevojshme të gjithë stafit e në veçanti të atij i cili është i lidhur drejtpërdrejtë me mirëmbajtjen dhe eksploatimin e infrastrukturës hekurudhore. Në këtë drejtim do të përgatiten një mori masash dhe do të zbatohet me përpikëri dokumenti mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë i cili do të jetë si udhërrëfyes për stafin ekzekutiv.

Ne edhe gjatë vitit 2026 e shohim si rrezik çështjen e vendkalimeve të pambrojtura rrugë – hekurudhë dhe për këtë angazhimi i jonë do të jetë shumë më i madh në sensibilizimin e autoriteteve përgjegjëse për gjetjen e një zgjidhjeje afatgjatë për këtë problem.

Qëndrueshmëria

Duke e vendosur në qendër qëndrueshmërinë e secilës punë të cilën ne e realizojmë, mendojmë se do të krijojmë një sistem hekurudhor të qëndrueshëm, ashtu që gjeneratat e ardhshme ta kenë më lehtë. Ne nuk pretendojmë që me këtë Plan të Biznesit dhe me kushtet ekzistuese do të ndryshojmë shumë gjërat, mirëpo me këtë dhe rrugën e filluar, gradualisht po ndërtojmë një të ardhme më të mirë për infrastrukturën hekurudhore.

Arritjen e një qëndrueshmërie të mirë gjatë vitit 2026 do ta bëjmë duke i realizuar detyrat kyçe të përcaktuara me këtë Plan të Biznesit dhe atë:

- Duke e zbatuar strategjinë zhvillimore për sektorin hekurudhor;
- Duke e vendosur prioritetin në investimet e infrastrukturës hekurudhore
- Duke siguruar burime financiare të qëndrueshme;
- Duke reduktuar në maksimum shpenzimet e tepërta;
- Duke zbatuar planet ditore, javore dhe mujore të punës në të gjithë sektorët;
- Duke trajnuar stafin ekzistues për realizim kompetent të detyrave dhe
- Duke menaxhuar dhe mbikëqyrë me kujdesin maksimal tërë zinxhirin e procesit të punëve në kompani.

Një numër i çështjeve të përmendura më lartë janë të lidhura me institucionet shtetërore dhe qasjen e tyre ndaj sistemit hekurudhor, mirëpo ne do të bëjmë çmos që t'i bindim këto institucione se investimi në hekurudhë është i domosdoshëm dhe se ka ardhur koha që të vepohet me urgjencë. S'do mend se investimi në hekurudhë është i shtrenjtë, mirëpo kthimi i këtyre investimeve është i shumëfishhtë.

Menaxhimi i aseteve

INFRAKOS-i është njëra ndër kompanitë me numrin më të madh dhe shtrirjen më të madhe të aseteve në tërë Republikën e Kosovës. Me 335.079 kilometra linja kryesore hekurudhore, 105,784 km linja në stacione, 103,4 km linja industriale, 115 ura, 759 lëshesa, 257 vendkalime, 850 hektar tokë, 32 stacione hekurudhore dhe shumë e shumë lokale, banesa dhe depo. Kjo kompani paraqet një potencial të madh dhe të vlefshëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Njëri ndër prioritetet tona do të jetë edhe regjistrimi dhe vlerësimi real i pronës së kompanisë duke e futur këtë nën një sistem të monitorimit i cili do t'i menaxhonte mirëfilltë të gjitha ndryshimet eventuale të aseteve, ashtu që në çdo moment të dimë gjendjen reale të tyre. Pra, gjatë vitit 2026 INFRAKOS-i pret që të gjenden mjetet financiare për blerjen e softuerit për zbatimin e planit të menaxhimit të aseteve për kompaninë tonë, në mënyrë që kjo çështje të zgjidhen një herë e përgjithmonë.

Kapacitetet dhe menaxhimi i performancës

Detyra e jonë primare ka qenë dhe mbetet që operatorëve hekurudhorë të ju ofrojmë kapacitete të mjaftueshme të traseve hekurudhore, ashtu që transporti i udhëtarëve dhe ai i mallrave të realizohet me sukses. Gjatë vitit 2025/26, INFRAKOS-i e ka realizuar me sukses ofrimin e të gjitha kapaciteteve të nevojshme për operatorët hekurudhor, duke i realizuar edhe kërkesat ad hok për trase shtesë, por e njëjta gjë nuk është ofruar për shfrytëzimin e linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani Elezit, pasi që linja është duke u rehabilituar. Ngjashëm ka ndodhur edhe me ofrimin e shërbimeve tjera të qasjes në rrjetin hekurudhor. Vlen të theksohet që gjatë vitit 2025 ne e kemi hapur linjën për shfrytëzim Prishtinë - Fushë Kosovë – Ferizaj dhe Gurëz dhe anasjelltas.

Gjatë vitit 2026, ofrohen shërbime të qasjes në rrjetin hekurudhor për operatorët e transportit, por duhet të theksojmë se në të njëjtën kohë jemi të gatshëm që në çdo moment të ofrojmë këtë lloj të kapaciteteve dhe shërbimeve edhe për operatorët tjerë eventual hekurudhor.

Gjatë vitit 2026 presim që përmes një menaxhimi të mirëfilltë të trafikut dhe procesit të planifikimit afatshkurtër dhe afatgjatë të bëjmë realizimin e suksesshëm të shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese hekurudhore duke mos harruar faktin se vetëm rreth 10% e kapaciteteve tona shfrytëzohen nga operatorët hekurudhor.



Projektet zhvillimore

INFRAKOS-i ka përcaktuar qartë projektet zhvillimore të cilat do t'i realizon gjatë vitit 2026, duke u bazuar në mundësitë e krijuara financiare dhe duke u mbështetur në financimin nga qeveria.

Ambicet tona gjithnjë kanë qenë më të mëdha sesa vlera e financuar nga Buxheti i Kosovës apo mundësia e limituar e buxhetit të kompanisë.

Të mbështetur nga Buxheti i Kosovës, BERZH-i, BEI-ja, dhe WBIF-i, projektet që do të realizohen gjatë vitit 2026, projektet të cilat vazhdojnë edhe pas vitit 2027, projektet e zotuar dhe të pa zotuar por të domosdoshme, janë prezantuar në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 1

Financimi	Emërtimi i projektit	Vlera për vitin 2026 në €
Projektet që financohen nga buxheti i Qeverisë (Ministria e Ekonomisë)	Furnizimi me traversa të ndërrueseve, me ballast si dhe shpërndarja e tij	100,000.00
	Servisimi i thellë i makinave të tampingut Pllaser, si dhe furnizimi me bateri i tyre	65,000.00
	Kostoja	165,000.00

Sipas tabelës Nr. 1 e kemi paraqitur financimin e projektit nga Qeveria e Republikës së Kosovës – ME, me të cilat mjete parashihet furnizimi i traversave të ndërruesve, furnizimi me ballast, servisimi i makinave tamping Pllaser dhe furnizimi me bateri.

Tabela Nr. 2

Financimi	Emërtimi i projektit	Parashikimet e Kontratës në €	Parashikimet 2026 në €
Projektet të cilat financohen nga BERZH-i, BEI-ja & WBIF	Përfundimi i rehabilitimit gjeneral të linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Faza I.	97,378,041.89	18,914,219.90
	Përfundimi i rehabilitimit i linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Mitrovicë – Faza II.	60,103,220.51	21,324,641.30
	Realizimi i Projekt dizajnit detaj teknik për fazën e tretë (Mitrovicë – Leshak)	3,269,000.00	1,300,000.00
	Mbikëqyrja e Projektit të Fazës së Parë	10,628,895.00	801,341.00
	Konsulenca Mbështetëse për Linjën 10 Hekurudhore	823,000.00	275,240.00
	Kostoja totale	172,202,157.40	42,615,402.20
Projektet që janë me prioritet e për të cilat pritet sigurimi i mjeteve financiare nga BERZH-i, BEI-ja & WBIF	Publikimi i tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë për rehabilitimin dhe modernizimin e sinjalizimit dhe telekomunikacionit për fazën e parë dhe të dytë të linjës 10-të hekurudhore (Hani Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë)	55,600,000.00	
	Konsulenca Mbështetëse për rehabilitimin e linjës 10-të hekurudhore Faza 2, 3 dhe S&T	1,200,000.00	
	Kostoja totale	56,800,000.00	

Projektet të cilat financohen nga BERZH-i, BEI-ja dhe WBIF-i

Gjatë vitit 2026 synohet përfundimi i punimeve të rehabilitimit të përgjithshëm të Fazës I (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), si dhe përfundimi i punimeve civile të Fazës II të rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10 (Fushë Kosovë – Mitrovicë) përkundër që projekti aktualisht nuk ka një datë të përcaktuar të përfundimit

Në fazën I, deri më tani është arritur progres i konsiderueshëm në implementimin e projektit. Janë përfunduar 64.5 km të linjës kryesore, që përfaqësojnë rreth 98% të punimeve. Binarët në stacione janë përfunduar, ndërsa të gjitha tunelet janë përfunduar, me përjashtim të një tuneli që mbetet në proces ndërtimi. Gjithashtu, janë përfunduar 4.4 km gabione, 3 km punime për mbrojtjen e pjerrësive, janë ndërtuar 100 lëshesa, janë përfunduar 20 ura prej betoni, janë instaluar 69 ndërrues binarësh dhe janë ndërtuar 56 km kanale për drenazhimin dhe largimin e ujërave.

Në fazën II, I është arritur progres i konsiderueshëm në implementimin e projektit. Janë përfunduar 31.0 km të linjës kryesore, që përfaqësojnë rreth 90% të punimeve. Janë përfunduar 1.2 km binarë në stacione (13%), 400 m gabione, janë ndërtuar 60 lëshesa, janë përfunduar 11 ura prej betoni, 3 nënkalime dhe janë instaluar 19 ndërrues binarësh.

Gjatë pjesës së fundit të vitit 2026 projekti pritet të hyjë në fazën finale të punimeve dhe të aftësohet dhe lëshohet në funksion për transporte të kufizuara.

Ndryshimet organizative

Në vitet paraprake sistemi hekurudhor në tërësi ka pësuar ndryshime të mëdha duke iu përshtatur trendëve ekzistuese të tregut të transportit. Mirëpo, për shkak të fokusimit të pamjaftueshëm të institucioneve përgjegjëse për këtë lloj të transportit, rezultatet e deritanishme nuk kanë qenë të kënaqshme. Në mënyrë që të përcjellim lëvizjet në tregun e transportit hekurudhor dhe ndryshimet më të fundit në sistemin e infrastrukturave hekurudhore evropiane. Në vitin 2022 është bërë ndryshimi i strukturës organizative të kompanisë e cila i ka sjellë kompanisë shumë probleme dhe komunikim jo të mirë brenda organizimit, prandaj Bordi i Drejtoreve i Infrakos Sh.A. në vitin 2023 ka aprovuar skemë të re organizative. INFRAKOS-i është çdoherë i gatshëm të hyjë në proces të ndryshimit të sistemit të menaxhimit me infrastrukturë duke tentuar që të krijohet një sistem i mirëfilltë i menaxhimit me të cilin do të realizohet pa problem vizioni dhe misioni i kompanisë. Edhe në vitin 2026 ne do të zbatojmë të gjitha procedurat e përcaktuara të cilat do të janë kompatible me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Fokusi i jonë kryesor është që të krijojmë strukturat e duhura dhe kompetente në të gjitha fushat, ashtu që INFRAKOS-i të ketë një sistem të avancuar të menaxhimit në mënyrë që kompania në afatin sa më të shkurtë të mund të funksionojë sipas standardeve evropiane.

Teknologjia dhe inovacionet

Do të vazhdon të bëhet edhe gjatë vitit 2026 modernizimi i linjave hekurudhore, pajisjeve sinjalo-siguruese, telekomunikuese, pajisjeve të kontrollit të lëvizjes së trenave dhe pajisjeve dhe makinerisë për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore. Ne kemi në funksion rrjetin digjital të telekomunikimit për tërë territorin, linjat hekurudhore të

cilat janë në një gjendje jo të mirë dhe një makineri tanimë të ripërtërirë për mirëmbajtjen e tyre. Prandaj, mbështetur në Strategjinë e Transportit Multimodal 2023-2030 kemi për qëllim modernizimin e tërë rrjetit hekurudhor, andaj gjatë vitit 2026 do të vazhdojnë punimet për rehabilitimin gjeneral për linjën Fushë Kosovë – Hani i Elezit, rehabilitimi i linjës Fushë Kosovë – Mitrovicë, ndërsa në vitet në vijim duhet të bëhet edhe rehabilitimi dhe modernizimi i pjesës veriore të linjës nga Mitrovica deri në kufirin me Serbinë. Në mënyrë të ngjashme do të bëhet edhe sigurimi i stacioneve me pajisjet elektronike sinjalo-siguruese dhe zgjerimi i sistemit qendror për kontrollin e lëvizjes së trenave. Orientimi jonë është i fokusuar edhe në bashkëpunimin e mirëfilltë me institucionet e ndryshme shkencore në mënyrë që të mund t'i inkorporojmë inovacionet dhe të arriturat më të reja në sistemin hekurudhor, ashtu që të kemi një cilësi më të mirë, siguri më të madhe dhe modelet më të avancuara të mirëmbajtjes.

SWOT analiza

Në arritjen e një suksesi të dëshiruar, INFRAKOS-i si analizon në detaje se cilat janë përparësitë, dobësitë, mundësitë, dhe rreziqet apo kërcënimet në mënyrë që kompania të funksionoi pa probleme dhe evitohen pengesat. Duke i analizuar të gjitha rrethanat dhe situatën ekzistuese kemi paraqitur SWOT analizën për vitin 2026. Me këtë analizë ne kemi përcaktuar qartë se cilat janë fuqitë apo përparësitë tona me të cilat ne mund të konkurrojmë me llojet tjera të biznesit të kësaj natyre dhe të cilat paraqesin prioritet për ne. Ngjashëm kemi analizuar mundësitë të cilat ne i kemi për zhvillimin e këtij biznesi, duke përfshi edhe dobësitë apo mangësitë të cilat mund të kenë ndikim të madh në biznesin tonë, ndërsa një trajtim i veçantë i kemi bërë rreziqeve të cilat do ta përcjellin biznesin gjatë vitit 2026. Në tabelën vijuese janë prezantuar disa nga pikat kryesore të këtyre çështjeve të përmendura më sipër e të cilat e përbëjnë SWOT analizën për vitin 2026.

<i>Fuqitë (Përparësitë)</i>	<i>Dobësitë (Mangësitë)</i>
→ I vetmi operator i cili ofron qasje në binarë; → Kycja në binarë industrial në pjesën më të madhe të minierave në Kosovë; → Ofrimi i shërbimeve të terminalit për ngarkim shkarkimin e mallrave; → Linja e 10 hekurudhore është linjë lidhëse ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut; → Kapacitetet e infrastrukturës ekzistuese lejojnë edhe futjen e operatorëve tjerë të transportit; → Eksperienca e gjatë në këtë biznes; → Dhënia e pronës me qira.	→ Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore; → Mosfunksionimi i linjave hekurudhore Prishtinë - Podujevë dhe Klinë - Prizren; → Kostoja e lartë e mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore; → Mungesa e stabilimenteve sinjalo-siguruese në të gjitha linjat hekurudhore, përveç linjës së 10; → Mosha e vjetër e punëtorëve, produktiviteti i ulët; → Mungesa e zbatimit të plotë të marrëveshjes pesë vjeçare me ministrin e linjës.

Mundësitë (Shanset)	Rreziqet (Kërcënimet)
→ Lidhja e të gjitha qyteteve kryesore të Kosovës mundëson zhvillimin e transportit hekurudhor; → Lidhja me vendet e rajonit përmes linjës së 10 dhe 7 hekurudhore; → Rehabilitimi dhe futja në funksion edhe e linjave tjera hekurudhore; → Infrastruktura e mirë jep mundësi për shtimin e operatorëve të transportit; → Lidhja hekurudhore me Portin e Durrësit.	→ Mosfunksionimi i mirë i Trainkos-it dhe Railtrans-it; → Mos financimi i plotë i marrëveshjes financiare pesë vjeçare ndërmjet Infrakos-it dhe Qeverisë për projektet zhvillimore të infrastrukturës; → Mosfunksionimi i pjesës veriore të linjës hekurudhore nga Mitrovica deri në kufirin me Serbinë; → Kostoja e lartë e investimeve në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e linjave jashtë funksionit; → Ndryshimi i politikave të BE-së dhe qasja e institucioneve zhvillimore të BE-së ndaj investimeve në rrjetin hekurudhor të Ballkanit Perëndimor.



Plani i të hyrave dhe shpenzimeve

<i>Analiza financiare</i>	<i>23</i>
<i>Të hyrat nga pagesat e qasjes në binarë</i>	<i>24</i>
<i>Të hyrat nga qiraja</i>	<i>25</i>
<i>Të hyrat tjera</i>	<i>26</i>
<i>Kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe subvencionimi nga shteti</i>	<i>27</i>
<i>Shpenzimet</i>	<i>28</i>
<i>Analiza e riskut</i>	<i>29</i>

Analiza financiare

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh. A. – INFRAKOS, përkundër vështirësive të ndryshme, gjatë vitit 2026 parasheh të zhvilloj afarizmin e vet me një trend të avancimit të lehtë në krahasim me vitet paraprake. Këtë duke e pasur parasysh se përveç shpenzimeve operacionale të domosdoshme për funksionim, nevojiten edhe burime financiare për projekte kapitale dhe mirëmbajtje të infrastrukturës hekurudhore që aktualisht burimi i vetëm për këto investime është BK-ja (Buxheti i Kosovës). Veprimtaria e INFRAKOS-it mbështetet në dhënien në shfrytëzim të traseve hekurudhore (nga të cilat trase realizohen pagesat e qasjes në binarë), nga dhënia me qira e patundshmërisë si dhe të hyra tjera jo konvencionale. Duhet të potencojmë se kërkesat tona për vlerën e pagesave për qasjen në rrjet dhe shërbimet tjera janë zbritur dukshëm nga ana e Ministria Infrastrukturës në Ekspozeun e Rrjetit për vitet e me hershme, ndërsa për vitin 2026 nuk është aprovuar ky dokument, mirëpo është duke u zbatuar me të njëjtat tarifa të aprovuara që nga viti 2013. Me këtë qasje të ministrisë ne nuk realizojmë të hyrat të mjaftueshme nga pagesat e qasjes në binarë. Andaj, diferenca e kësaj tarife realizohet me implementimin e plotë të marrëveshjes pesë vjeçare financiare ndërmjet qeverisë dhe INFRAKOS-it për financimin afatgjatë të kompanisë.

INFRAKOS-i përveç të hyrave nga qasja në binarë, realizon të hyra edhe nga qiraja përmes shfrytëzimit të patundshmërisë, qiraja nga kablloptike sipas kontratës me TK-në dhe të hyrat tjera. Për të hyrat nga patundshmëria, në vitin 2026 do të kemi angazhime shtesë për menaxhim më të mirë të këtij sektori andaj është planifikuar një rritje e lehtë, pasi që në periudhën 2024-2025 janë maksimizuar të hyrat nga ky sektor.

Në tabelën vijuese janë prezantuar të hyrat e realizuara dhe të planifikuara me rishikim për 2026.

Tabela 1: Të hyrat- buxheti i rishikuar për vitin 2026

Nr	Përshkrimi	Buxheti i planifikuar 2026	Të hyrat e realizuara Janar – Qershor 2026	Të Hyrat e planifikuara Korrik – Dhjetor 2026	Të hyrat e planifikuara me rishikim 2026
		A	B	C	D
1	Të hyrat nga pagesat e qasjes në binarë	174,000.00	82,984.46	91,015.54	174,000.00
2	Të hyrat nga qiraja	1,390,000.00	766,262.66	663,733.34	1,430,000.00
3	Të hyrat tjera	174,200.00	101,240.19	72,959.81	174,200.00
4	Të hyrat e shtyra nga grante-BK	840,000.00	359,403.66	350,596.34	710,000.00
5	Subvencionimi nga Qeveria	1,300,000.00		1265,000.00	1,265,000.00
	Gjithsejtë të hyrat	3,878,200.00	1,309,890.97	2,443,305.03	3,753,200.00

Të hyrat nga pagesat e qasjes në binarë

Për vitin 2026, INFRAKOS-i ka përpiluar një Ekspoze të Rrjetit në përputhje të plotë me Ligjin mbi Hekurudhat dhe konform rregulloreve dhe standardeve evropiane të cilat e rregullojnë këtë fushë. Pagesat e qasjes në rrjet për vitin 2026 janë llogaritur sipas kostove direkte të mirëmbajtjes së rrjetit ekzistues hekurudhor i cili është në funksion dhe duke u bazuar në ligjin mbi hekurudhat dhe Direktivat Evropiane të cilat e rregullojnë këtë çështje. Meqenëse realizimi i të hyrave nga pagesat e qasjes në binarë varet 100% nga operatorët e transportit hekurudhor (në rastin tonë TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i), duke pasur parasysh se numri i trenave të udhëtarëve në vitin 2026 do të jetë përafërsisht i njëjtë me vitin 2025, ditur se transporti i mallrave nuk është duke u zhvilluar për shkak të punimeve. Nga fakti se tarifat e pagesave të qasjes në binarë janë zvogëluar në mënyrë drastike nga Ministria e Infrastrukturës, në vitin 2026 sipas parashikimeve më optimiste të hyrat nga qasja në binar (transporti) kapin vlerën prej rreth 174,000.00 €. Bazuar në këtë që u tha më lartë, diferenca ndërmjet kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe kostoja e pambuluar të cilën planifikohet të realizohet nga zbatimi i marrëveshjen financiare pesëvjeçare është në vlerë prej 3,786,897.00 €. Infrakos do të angazhohet në vazhdimësi që kjo diferencë të subvencionohet nga Ministria e Infrastrukturës.

Të hyrat nga qiraja

Të hyrat nga qiraja aktualisht paraqesin një komponent tejet të rëndësishëm për ruajtjen e likuiditetit të ndërmarrjes në këtë periudhë kur transporti i mallrave nuk zhvillohet për shkak të punimeve në linjën 10-të. Në këtë fushë janë aprovuar politika që maksimizojnë shfrytëzimin e kapaciteteve, e që janë reflektuar me performances në rritje të vazhdueshme. Andaj edhe gjatë vitit 2026 dhe në periudhën vijuese presim rezultate më të mira në këtë fushë. Sipas planifikimeve të rishikuara të hyrat e planifikuara nga qiraja për vitin 2026 arrijnë vlerën prej 1,430,000.00 euro që paraqet një rritje në raport me planifikimet fillestare të projektuar për 2026 prej 1,390,000.00 €.

Të hyrat tjera

Në këtë grup të të hyrave bëjnë pjesë të hyrat nga terminali i mallrave, të hyrat nga mirëmbajtja e binarëve industrial për kompanitë private dhe të hyrat tjera të cilat mund të realizohen nga ofrimi i ndonjë shërbimi për palët e treta, përfshirë këtu edhe shitjen e materialeve të panevojshme të demantuara nga linjat hekurudhore.

Terminali i mallrave i cili gjendet në stacionin hekurudhor të Miradisë për shkak të punimeve në linjën 10-të edhe gjatë vitit 2026 do të punojë me kapacitet të kufizuar përkundër kapaciteteve për të ofruar shërbime cilësore, të shpejta, korrekte dhe jo diskriminuese për të gjithë shfrytëzuesit e tij. Në mënyrë të ngjashme do të punohet edhe për ndërtimin eventual të binarëve privat industrial dhe mirëmbajtjen e binarëve

ekzistues industrial. Nga kategoria e të hyrave tjera planifikohet të realizohen të hyra në vlerë prej 174,200.00 €, këto të hyra parashihen të realizohen materialeve të përdorshme (skrap) dhe të hyrave të tjera nga aktivitetet e ndërmarrje.

Kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe subvencionimi i INFRAKOS-it

Kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës për vitin 2026 ka dalë nga llogaritjet e bëra bazuar në Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063, respektivisht Neni 65 i cili thotë:

“Neni 65 – Kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës

1. Shpenzimet e drejtpërdrejta që dalin nga mirëmbajtja e infrastrukturës duhet të vlerësohen dhe konsiderohen kur të vendosen principet e përcaktimit të pagesës dhe nivelet e pagesës së qasjes.

2. Akti nënligjor, në pajtim me Direktivën e BE-së 2001/14 dhe Propozim Direktivën për Hapësirën Unike Evropiane të Transportit, e shtatorit 2010, duhet të cekë elementet që konsiderohen kosto direkte e shkaktuar për nga shërbimi i trenit dhe mirëmbajtja e infrastrukturës”.

Bazuar në nenin e mësipërm dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2013 të datës 28.06.2013 të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës mbi përcaktimin e koston direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës, INFRAKOS-i ka bërë llogaritjen e kostove direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës për vitin 2026, gjithashtu sipas Ligjit mbi Hekurudhat, përveç diferencës ndërmjet koston direkte dhe të hyrave të realizuara nga pagesat e qasjes në binarë, Qeveria do të duhej t'i subvenciononte edhe shpenzimet tjera operative të pambuluara të cilat mjete parashihen në marrëveshjen financiare pesë vjeçare e cila është nënshkruar ndërmjet Infrakos-it dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në baze të marrëveshjes pesë vjeçare të nënshkruar subvencionimi i diferencës së qasjes në rrjet është planifikuar të jetë 3,786,897.00 €.



Shërbimet e terminalit



Ndërtimi i binarëve industrial privat

Pavarësisht planifikimeve nga marrëveshja pesë vjeçare, të hyrat nga subvencionet e shtetit për vitin 2026, planifikohet të jetë 1,265,000.00 €, e cila vlerë prezantohet në tabelën vijuese:

Nr.	Kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe Subvencionimi i INFRAKOS-it	Viti 2026 (€)
1	Kostoja direkte dhe indirekte	3,038,200.00
2	Të hyrat nga qasja në rrjet, qiratë, terminali dhe binarët industrial	1,778,200.00
3	Subvencionimi nga Qeveria	1,265,000.00

Kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës e cila sipas Ekspozeut të Rrjetit 2026 do të duhej të realizohet nga të hyrat nga operatori hekurudhor TRAINKOS dhe RAILTRANS në emër të pagesave të qasjes në binarë sipas vendimit të Ministrisë së Infrastrukturës për zbritjen e tarifave të qasjes në binarë.

Bazuar në këto tarifa, kostoja direkte e mirëmbajtjes në përputhje me ligjin për hekurudhat duhet të subvencionohet nga qeveria e Kosovës, edhe gjatë vitit 2026 vazhdon subvencionimi i pjesshëm i koston direkte, ndërsa diferenca mbulohet nga të hyrat vetanake të ndërmarrjes.

Shpenzimet

Me rishikim, për vitin 2026 janë planifikuar **3,485,866.00€** shpenzime, që në krahasim me planifikimet fillestare prej 3,752,893.00€, paraqet një ulje të shpenzimeve për 267,027.00 € apo 7%.

Një reduktim i tillë i shpenzimeve është planifikuar përkundër akomodimit të buxhetit shtesë në linjën e pagave për adresim të impaktit të pagës minimale dhe inicimin e disa projekteve që ndërlidhen me gjetje nga auditimet si vlerësimi pasurisë, softueri financiar dhe vlerësimi riskut. Në këto shpenzime bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet e kompanisë, duke filluar nga blerja e pajisjeve, pjesëve rezervë, mjeteve të punës, materialeve shpenzuese, riparimet, shpenzimet administrative, ligjore dhe pagat e punonjësve.

Tabela 2: Shpenzimet e planifikuara në buxhetin e vitit 2026 dhe shpenzimet e planifikuara me rishikim për vitin 2026:

Nr.	Përshkrimi	Shpenzimet e planifikuara 2026	Shpenzimet e planifikuara me RISHIKIM 2026	Diferenca
		A	B	C
1	Pajisjet	15,510.00	20,900.00	5,390.00
2	Harxhimet në lokale (ndërtesa)	74,000.00	44,500.00	-29,500.00
3	Energjia elektrike	154,000.00	168,000.00	14,000.00
4	Nafta	24,900.00	37,647.00	12,747.00
5	Vajrat, lubrifikantët etj.	3,850.00	3,850.00	0.00
6	Materiali harxhues operativ	111,460.00	108,160.00	-3,300.00
7	Riparimet	105,500.00	92,000.00	-13,500.00
8	Shërbimet operative	4,000.00	4,000.00	0.00
9	Udhëtimet zyrtare	9,025.00	9,025.00	0.00
10	Marketingu dhe publikimet	5,300.00	5,300.00	0.00
11	Shkollim/Trajnime	2,500.00	2,500.00	0.00
12	Materiali i zyrës dhe konsumues	28,400.00	32,150.00	3,750.00
12	Telefoni, posta dhe interneti	11,490.00	12,330.00	840.00
13	Shpenzimet e rezikshmërisë	158,000.00	178,000.00	20,000.00
14	Shpenzimet e reprezent., konsumuese	5,040.00	5,040.00	0.00
15	Sigurimi	98,552.00	78,000.00	-20,552.00
16	Stafi i jashtëm	3,000.00	3,000.00	0.00
17	Stafi dhe punëtorët	1,860,468.00	1,908,768.00	48,300.00
19	Shpenzime tjera operative	110,500.00	75,298.00	-35,202.00
20	Shpenzimet e zhvlerësimit	960,000.00	690,000.00	-270,000.00
21	Shpenzimet e interesit të kredisë	7,398.00	7,398.00	0.00
Gjithsejtë shpenzimet		3,752,893.00	3,485,866.00	267,027.00

Tabela 3: Rezultatit financiar: Realizimi janar-Qershor 2026, buxheti planifikuar 2026 dhe buxheti rishikuar 2026.

Nr.	Përshkrimi	Realizimi 2026 (realizimi Janar- Qershor)	Buxheti i planifikuar 2026	Buxheti I REVIDUARV 2026	Diferenca
		A	B	C	B-C
1	Gjithsejtë të hyrat		3,878,200.00	3,753,200.00	125,000.00
2	Gjithsejtë shpenzimet		3,752,893.00	3,485,866.00	267,027.00
Rezultati Netë			125,307.00	267,334.00	

Në bazë të planit të biznesit, ndërmarrja pritet të ketë një rezultat financiar pozitiv prej 267,027.00€, apo prej 7%. Në raportin me rezultatin pozitiv të projektuar prej 125.000€ paraqet një ngritje prej 141.720€ apo prej 113%. Objektivi i menaxhmentit që përmes politikave të kujdesshme të shpenzimeve ky rezultat të përmirësohet edhe me tutje.

Analiza e riskut

Shtirja e objektivave tona nga lartë – poshtë për tërë stafin e kompanisë, paraqet një linjë të qartë të përgjegjësiave për secilin dhe një detyrim që moskryerja eventuale e detyrave të planifikuara do të rrezikon realizimin e të hyrave të parapara me çka do të cenohet ekzistenca e kompanisë e me këtë edhe arritja e vizionit tonë. Për këtë arsye, duke filluar nga menaxhmenti e deri tek njësitë më të vogla të kompanisë, kërkohet të bëhen planet e veprimit dhe mekanizmat e kontrollit, ashtu që të garantohen rezultatet e pritshme dhe kompania të operojë me sukses.

Varësisht nga fushëveprimi i secilit sektor, janë paraqitur objektivat e qarta dhe janë përpiluar planet e veprimit të cilat duhet të realizohen në vitin 2026 dhe ne presim që në çdo hallkë të zinxhirit veprues të kemi rezultate pozitive.

Mosrealizimi eventual i objektivave të Sektorit për Mirëmbajtjen e Linjave Hekurudhore, Sektorit për SS, TK dhe EN, Sektorit të Komunikacionit si dhe Sektorit të Patundshmërisë, do ta rrezikonte realizimin e të hyrave të planifikuara e kjo do ta cenonte sigurinë e lëvizjes së trenave.

Një rendësi të veçantë paraqet edhe implementimit të Marrëveshjes Financiare pesëvjeçare nga ana e qeverisë dhe e Infrakos-it do të sigurohej funksionimi i rregullt i INFRAKOS-it, pa të cilën Infrakos nuk do të mund garantonte siguri gjatë zhvillimit të komunikacionit hekurudhor.



Rezultatet

<i>Kontributi i jonë në arritjen e rezultateve</i>	28
<i>Rreziqet në vendkalime</i>	29
<i>Ofrimi i kapaciteteve të reja</i>	30
<i>Sigurimi i qasjes</i>	30

Kontributi i jonë në arritjen e rezultateve

Gjatë vitit 2026 Menaxhmenti i INFRAKOS-it do të ketë angazhime shumë më të mëdha, në mënyrë që Plani i Biznesit të realizohet me sukses dhe rezultatet e këtyre angazhimeve të jenë të dukshme. Që të gjithë sektorët ekzekutiv duke filluar nga secili individ do të japin kontributin e tyre maksimal në realizimin me sukses të detyrave të parapara në mirëmbajtjen e linjave hekurudhore, pajisjeve SS, TK dhe EN, si dhe organizimin e sigurt të qarkullimit të trenave. Ngjashëm do të bëjnë edhe sektorët mbështetës të administratës duke filluar nga resurset njerëzore, financa të deri të logjistikës.



Një sistem i kontrollit ekziston përmes të cilit do të përcillet, analizohet dhe vlerësohet puna dhe kontributi i secilit, mirëpo ky sistem i kontrollit është më se i nevojshëm për rishikim, prandaj edhe duhet të ndërmarrim masa për ndryshim. Edhe pse rezultatet tona janë të varura dhe ndikohen nga shumë faktorë tjerë të jashtëm dhe institucional, ne jemi të bindur se me angazhimet tona maksimale do të arrijmë rezultatet e pritura që në vitin 2026 të kemi një infrastrukturë më të mirë dhe më të qëndrueshme.

Rritja e shkallës së sigurisë

Prioriteti mbi të gjitha prioritetet e INFRAKOS-it gjatë vitit 2026 do të jetë rritja e shkallës së sigurisë për punonjësit tanë, udhëtarët dhe publikun. Ne mendojmë se sa më e sigurt të jetë infrastruktura hekurudhore, aq më e lartë do të jetë performancës e saj.

Aksidentet me tren - Për vitin 2025 ne kemi ndërmarrë të gjithë hapat e duhur për realizimin e detyrave të parapara ashtu që të arrihet siguria maksimale. Në këtë drejtim ne pretendojmë që të zvogëlojmë në maksimum dhe me tendencë të eliminimit të tërësishëm numrin e aksidenteve të trenave.

Pra gjatë vitit që e kemi lënë pas, janë siguruar edhe tri vendkalime me të frekuentuara (njëra në Bardh dhe dy të tjera në Pejë) rrugë – hekurudhë gjë që e rrisin sigurinë në komunikacionin hekurudhor dhe me automatizëm e zvogëlojnë numrin e aksidenteve. Po ashtu, ne kemi ngritur në maksimum përgjegjësinë e secilit, duke bërë shkollimin / trajnimin e vazhdueshëm me stafin ekzekutiv, duke ndërmarrë masa rigorozë disiplinore ndaj përgjegjësve të cilat veprime do të ndikonin që numri i aksidenteve në vitin 2026 të zvogëlohet.

Rreziqet në vendkalime – Njëra ndër brengat kryesore gjatë viteve të kaluara ka qenë numri i madh i aksidenteve në vendkalimet e pambrojtura rrugë – hekurudhë ku në raste të caktuara ka pasur edhe humbje të jetës së njerëzve. Në të gjitha rastet e këtyre aksidenteve fajtorë janë pjesëmarrësit e komunikacionit rrugor pasi që ata nuk i zbatojnë rregullat e trafikut gjatë kalimit nëpër vendkalimet e pambrojtura. Dihet se të gjitha këto vendkalime të pambrojtura i kanë shenjat përkatëse rrugore të cilat paralajmërojnë kryqëzimin e rrugës me hekurudhë dhe se pjesëmarrësit në komunikacion duhet t'i zbatojnë ato shenja.

Ne gjatë vitit 2025 kemi arritur që t'i instalojmë 3 laura në kryqëzimet me të frekuentuara në linjën Prishtinë – Pejë.



Ndërsa një problem tjetër këtu paraqet numri i madh i vendkalimeve të pambrojtura dhe duke marrë parasysh koston shumë të lartë në si Infrakos Sh.A mbesim që edhe me tej t'i paralajmërojmë organet kompetente që ta bëjnë mbrojtjen dhe sigurimin e vend kalimeve në nivel rrugë-hekurudhë varësisht se në cilën pjesë graviton hekurudha.

Një problem në vete paraqet numri i madh i vendkalimeve ilegale të cilat në vazhdimisht i eliminojmë por që mbetet shqetësuese për shkak të cenimit të sigurisë në komunikacionin. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2025 deri me tani i kemi pasur gjithsejtë 9 (nëntë) aksidente 1 (një) i vdekur dhe 7 (shtatë) të lënduar. Por e rëndësishme që të potencohet se të gjitha këto aksidente kanë ndodhur në vendkalime legale të mbrojtura me shenja të komunikacionit rrugorë dhe që në asnjë rast këto aksidente nuk kanë ndodhur me përgjegjësinë e Infrakos-it. Ne synojmë që për vitin 2026 siguria të mbetet prioritet në mënyrë që numri i aksidenteve të jetë zero.

Vendkalimet ilegale në momentin e parë të identifikimit të tyre, ekipet e Infrakos-it e menjëherë bëjnë rrënimin e tyre. Ekzistojnë vendkalime ilegale që kanë ndërtuar komunitat dhe personat fizik pa konsultim paraprak me Infrakos, e për të cilat u janë dërguar shkresa për marrje të masave adekuata në mënyrë që mos të rrezikohet siguria në komunikacion.

Për vitin 2026 si çdo vit tjetër paraprak, Infrakos Sh.A ka paraparë të intensifikojë edhe më shumë një fushatë edukuese dhe informuese përmes mjeteve të informimit, në mënyrë që palët mos të ndërhyjnë në trase hekurudhore pa pëlqime paraprake, gjithashtu është bërë dhe do të bëhet edhe sensibilizimi për pjesëmarrësit e komunikacionit rrugorë në mënyrë që të kenë kujdes më të madh gjatë kalimit nëpër vendkalimet në nivel, njëkohësisht do të rrisim bashkëpunimin me institucionet tjera përgjegjëse siç janë Ministria MI-së, Policia e Kosovës dhe komunitat në drejtim të mbrojtjes, informimit dhe gjetjes së modeleve më të mira për ngritjen e sigurisë në vendkalimet rrugë - hekurudhë.

Ofrimi i kapaciteteve të reja

Gjatë vitit 2026 INFRAKOS-i do të ofroj në shfrytëzim për operatorët hekurudhorë këto linja hekurudhore:


- ➔ Prishtinë – Fushë Kosovë;
- ➔ Fushë Kosovë – Hani i Elezit;
- ➔ Fushë Kosovë – Mitrovicë;
- ➔ Fushë Kosovë – Pejë; dhe
- ➔ Bardh – Magurë.

Linjat hekurudhore Prishtinë – Podujevë dhe Klinë - Xërxe – Prizren për shkak të dëmtimeve shumë të mëdha janë jashtë përdorimit, ndërsa linja Mitrovicë – Leshak për shkak të situatës politike në veriun e Kosovës po ashtu është jashtë përdorimit. Ndërsa linja Fushë Kosovë – Hani i Elezit dhe Fushë Kosovës - Mitrovicë aktualisht janë në fazën e punimeve dhe pritet që të lëshohen në funksion pjesërisht në pjesën e fundit 2026, andaj edhe si të tilla i kemi lënë si mundësi e ofritit për shfrytëzim nga operatorët transportues hekurudhor.

Sigurimi i qasjes

Duke u nisur nga motoja e vjetër se “klienti gjithnjë ka të drejtë”, INFRAKOS-i edhe gjatë vitit 2026 do të ofron qasje në linjat hekurudhore për të gjithë trenat e operatorëve ekzistues hekurudhor TRAINKOS dhe RAILTRANS, si dhe të gjithë operatorët tjerë potencial hekurudhorë.

Profesionalizmi, përgatitja dhe zotësitë e dëshmuara të punonjësve tanë, janë garanci e madhe për të gjithë operatorët hekurudhor se të gjitha trasetë e ndara sipas Ekspozeut të Rrjetit 2026 do të realizohen në mënyrë efikase, efektive dhe brenda parametrave të sigurisë. Veç kësaj, mund të ofrohen edhe qasje në trase të reja sipas kërkesave “ad hoc” pasi kapaciteti i shfrytëzimit të linjave hekurudhore është tejet i vogël dhe gjithnjë ka mundësi për shfrytëzim me te madhe si në transportin e mallrave ashtu edhe te udhëtarëve.



Shpërndarja, rreziqet dhe supozimet

<i>Shpërndarja e programeve</i>	32
<i>Supozimet tona kyçe</i>	33
<i>Vlerësimi i rreziqeve</i>	34

Shpërndarja e programeve

Në vitin 2026 kemi përgatitur programet dhe planet e veprimit për secilin sektor ashtu që me zbatimin e tyre të kemi një performancë të suksesshme në këtë vit. Në tabelën vijuese janë prezantuar detyrat kyçe të cilat do t'i realizon INFRAKOS-i në vitin 2026 dhe shpërndarja e realizimit nëpër muaj.

Nr.	Emërtimi i punëve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Mirëmbajtja e rregullt ditore e linjave hekurudhore, pajisjeve SS, TK & EN, dhe organizimi i lëvizjes së trenave												
2	Intervenimet në eliminimin e pengesave të linjave hekurudhore, pajisjeve SS, TK & EN,												
3	Mirëmbajtja dimërore, eliminimi i borës dhe akullit												
4	Pastrimi i profilin të linjave hekurudhore dhe kanaleve ujë përcjellëse												
5	Pastrimi i barojave me herbicide nëpër linjat hekurudhore												
6	Zëvendësimi i traversave të vjetruara dhe materialit përforcues												
7	Matja e gjeometrisë së binarëve me makinat matëse												
8	Përgatitja e tenderëve për projektet kapitale dhe publikimi i tyre												
9	Realizimi i furnizimeve sipas tenderëve për projektet kapitale												
10	Menaxhimi i pronës (kontraktimi, faturimi, inkasimi dhe mbledhja e borxheve paraprake)												
11	Rehabilitimi i Linjës së 10 hekurudhore faza 1 (Fushë Kosovë – Hani i Elezit)												
12	Rehabilitimi i Linjës së 10 hekurudhore faza 2 (Fushë Kosovë – Mitrovicë)												
13	Rehabilitimi i pajisjeve sinjalo siguroese dhe të energjetikës për fazën e parë dhe të dytë (Mitrovicë – Hani i Elezit).												
14	Përfundimi i projekt dizajnit për rehabilitimin dhe modernizimin e fazës së tretë të linjes së 10-të hekurudhore (Mitrovicë - Leshak - Kufiri me Serbinë) përfshirë sinjalizimin dhe telekomunikacionin.												
15	Dizajni Preliminar i Linjave Hekurudhore Fushe Kosovë-Klinë-Pejë dhe Klinë-Prizren.												
16	Sigurimi i Vendkalimeve në Hekurudha												

Supozimet tona kyçe

Në mënyrë që ta zbatojmë me sukses Planin tonë të Biznesit për vitin 2026, ne kemi bërë një varg të supozimeve dhe ngjarjeve të cilat mund të kenë ndikim në planin tonë, duke llogaritur kështu detajet më të imta të këtyre ngjarjeve ashtu që rezultati final të jetë i mirë. Në këtë kontekst kemi përcaktuar disa nga supozimet tona kyçe të cilat ndërlidhen me ngjarjet e mundshme në vitin 2026.

Gjendja ekonomike – Është evidente se që nga viti 2013 ka pasur një rënie të madhe të transportit të mallrave si dhe punimet në linjën 10-të, që kanë ndikuar dukshëm në zvogëlimin e të hyrave tona nga pagesat e qasjes në binarë. Mbetemi me shpresë se pas lëshimit në funksion të linjës 10-të operatorët e transportit hekurudhor do të bëjnë angazhime shtesë për rritjen e transportit, me ç'rast do të përfitonte edhe INFRAKOS përmes rritjes së të hyrave nga qasja në binar.

Korniza rregullative dhe kontraktuale – Në vitin 2026 ne po ashtu presim që të përforcohet korniza rregullative e sistemit hekurudhor, ku Ministria e Infrastrukturës do të nxjerr aktet nënligjore (Udhëzimet Administrative) me të cilat do të përcaktohet mënyra e detajuar e rregullimit të sistemit hekurudhor dhe në veçanti mënyra e financimit të infrastrukturës hekurudhore. Me këtë do të zgjidhet problemi i përpilimit dhe miratimit të Ekspozeut të Rrjetit në të ardhmen, gjë që për INFRAKOS-in do të paraqiste një lehtësi të madhe.

Teknologjia – Gjatë viteve të fundit kemi bërë modernizimin e makinave për mirëmbajtjen e binarëve e kjo ka ndikuar shumë në ngritjen e nivelit të mirëmbajtjes dhe çka është më e rëndësishme në ngritjen e sigurisë së qarkullimit të trenave nëpër linjat tona hekurudhore. Në të njëjtën kohë në gusht të vitit 2019 ka filluar rehabilitimi dhe modernizimi i fazës 1 të linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), dhe në vitin 2022 ka filluar rehabilitimi i fazës 2 (Fushë Kosovë – Mitrovicë) dhe në të njëjtën kohë vazhdon të kryhet edhe projekt dizajni i linjës hekurudhore (Mitrovicë – Leshak) Pasi të sigurohet fondi për këtë linjë, gjë që paraqet një sukses shumë të madh drejt përmirësimeve teknologjike dhe rritjes së sigurisë së qarkullimit. Mjetet për hartimin e projekt dizajnit për modernizimin e linjës hekurudhore (Fushë Kosovë – Klinë – Pejë) dhe të linjës hekurudhore (Klinë – Prizren), janë siguruar nga Buxheti i Kosovës, ku edhe gjatë vitit 2026 ky projekt pritet të jetë në proces.

Vlerësimi i rreziqeve

Ngjashëm me supozimet tona ne kemi bërë edhe analizën e rrezikut të mosrealizimit të Planit tonë të Biznesit në vitin 2026. Ne kemi llogaritur dhe analizuar çdo detaj dhe në vijim kemi paraqitur disa nga çështjet kyçe të cilat mund ta rrezikojnë realizimin e Planit të Biznesit.

Siguria dhe qëndrueshmëria – Në analizën tonë kjo çështje e zënë vendin e parë dhe do të ketë efektin negativ nëse ne:

- ➔ Nuk e bëjmë mirëmbajtjen e duhur dhe të planifikuar të infrastrukturës hekurudhore;

- Nuk ndërmarrim veprimet e nevojshme që të iu paraprimë dëmtimeve dhe vjedhjeve të infrastrukturës nga palët e treta dhe nuk i paraprimë veprimeve të parapara lidhur me vendkalimet rrugë-hekurudhë.

Mundësitë e kompanisë – Në analizën tonë si mundësi kryesore të kompanisë ne kemi veçuar menaxhimin e aseteve, menaxhimin e kapaciteteve dhe performancës, si dhe zhvillimin e projekteve kapitale. Rreziku qëndron në:

- Përmirësimet e pamjaftueshme në menaxhimin e aseteve;
- Përmirësimet e vonuara në rregullimin e data bazës së aseteve dhe eliminimin e borxheve të këqija;
- Mosbalancimi ndërmjet performancës, kapaciteteve dhe kostos;
- Përmirësimet e pamjaftueshme në realizimin e projekteve;
- Puna joefektive e partneritetit me palët e interesit;
- Dështimet e menaxhmentit për realizimin e detyrave sipas Planit të Biznesit.

Lehtësitë – Në analizën tonë po ashtu kemi përcaktuar lehtësitë kyçe për arritjen e objektivave tona me Planin e Biznesit e të cilat përfshinë teknologjinë dhe inovacionet, ndryshimet organizative, resurset njerëzore, transparencën dhe financimin. Rreziku këtu qëndron në:

- Mungesën e përmirësimit të komunikimit;
- Mungesën e përmirësimeve teknologjike;
- Mungesën e përmirësimeve në strukturën organizative të paraparë me plan;
- Mungesën e stafit kompetent për realizimin e detyrave;
- Mungesën e financimit të mjaftueshëm nga Qeveria; dhe
- Paaftësia e menaxhmentit që t'i përshtatet ndryshimeve dhe transformimeve të sistemit hekurudhor.

Struktura, kapacitetet njerëzore


<i>Struktura organizative e kompanisë</i>	36
<i>Resurset njerëzore</i>	37

Struktura organizative e kompanisë

Në funksion të përmirësimit të menaxhimit, rritjes së performancës së kompanisë dhe për të arritur rezultate më të mira në fushën e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve, gjatë vitit 2023 kemi ndërmarrë ndryshime të rëndësishme në strukturën organizative të ndërmarrjes. Kjo strukturë e re u miratua nga Bordi i Drejtorëve në muajin gusht 2023 dhe është paraqitur në diagramin më poshtë. Struktura aktuale është e orientuar drejt funksioneve kyçe të ndërmarrjes dhe deri më tani ka dëshmuar efikasitet dhe përshtatshmëri me nevojat operacionale të kompanisë.

Perspektiva Afatgjatë - megjithëse struktura aktuale po funksionon mirë, mirëpo në planin afatgjatë parashihet rishikimi i mëtejshëm i funksioneve, me qëllim që të përshtatemi me zhvillimet e shpejta teknologjike, të kemi fleksibilitet ndaj ndryshimeve të mundshme në gjendjen financiare të ndërmarrjes dhe të sigurojmë një strukturë që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore.

Kjo qasje do të zbatohet nëpërmjet politikave të qëndrueshme të menaxhimit të burimeve njerëzore me qëllim që të ofrohen shërbime efikase dhe efektive, të sigurohet një nivel i lartë i sigurisë operacionale dhe të funksionojnë mekanizma të brendshëm të kontrollit në përputhje me standardet moderne në mënyrë që të optimizohen kostot e operimit.



Resurset njerëzore

Politikat e ndërmarrjes INFRAKOS në fushën e burimeve njerëzore janë të orientuara drejt sigurimit të një stafi profesionalisht të përgatitur, i cili është në gjendje të përmbushë përgjegjësitë në mënyrë efikase dhe të ofrojë zgjidhje për problemet dhe marrjen e vendimeve në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

Objektivat kryesore të këtyre politikave janë - Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe efikase për të gjithë, menaxhim efektiv dhe në përputhje me ligjet, përmbushje e përgjegjësiwe institucionale me efikasitet të lartë.

Ngritja e Kapaciteteve dhe Trajnimi - Në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale, politikat janë të orientuara drejt menaxhimit efikas të burimeve njerëzore, arsimit të vazhdueshëm profesional në fushën hekurudhore përmes shkollimeve të rregullta dhe trajnimeve periodike, trajnimeve specifike sipas nevojave operative, rishikimit të funksioneve, përmirësimit të shëndetit, sigurisë në punë dhe mirëqenies së punonjësve.

Këto do të mbesin ndër prioritetet më të larta të INFRAKOS-it edhe gjatë vitit 2026.

Sfidat dhe Planifikimi Afatgjatë - Një nga sfidat kryesore të ndërmarrjes mbetet mosha mesatare e lartë e stafit (54 vjeç), e cila ndikon në aftësinë për të absorbuar ndryshime teknologjike dhe në planifikimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore. Për të adresuar këtë sfidë, politikat do të përqendrohen në zhvillimin e mëtejshëm të personelit ekzistues, mbulesën e nevojave emergjente me staf të ri dhe rishikimin esencial të funksioneve organizative. Qëllimi është të arrihet një ndërthurje efikase mes kapaciteteve humane dhe teknologjike, duke siguruar ofrim të shërbimeve moderne me staf të kualifikuar, pajisje të avancuara dhe kosto sa më të ulët.

Politikat e Punësimit - Në fushën e punësimeve, ndërmarrja synon ruajtjen e niveleve ekzistuese të stafit, pavarësisht nevojave të vazhdueshme për staf në fusha specifike hekurudhore. Punësimet do të realizohen në fushën e financave, burimeve njerëzore dhe inxhenerike si nevoja të domosdoshme për rritje të kontroleve të brendshme, disa pikave kyçe profesionale se dhe zëvendësimi i stafit që pensionohet apo nevojave e veçanta që mund të paraqiten gjatë operimeve. Qëllimi strategjik është qasje konservative në punësime me qëllim që të ruhen nivelet aktual të punonjësve deri në përfundimin e punimeve në modernizimin e të gjitha linjave hekurudhore që janë aktualisht në proces rehabilitimit.



E ardhmja

<i>Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore, perspektivë afatgjate e zhvillimit ekonomik</i>	<i>39</i>
<i>Pse infrastruktura hekurudhore</i>	<i>40</i>

Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore, perspektivë afatgjate e zhvillimit ekonomik

Menaxhmenti i INFRAKOS-it ka marrë një detyrim karshi aksionarit dhe publikut të gjerë se do të bënë çmos për përmbushjen e këtij Plani të Biznesit dhe objektivave që dalin nga ky plan.

Ne jemi të vetëdijshëm për situatën ekzistuese ekonomike të vendit dhe pamundësinë e investimeve të mëdha në infrastrukturën hekurudhore. Mirëpo, ne jemi koherent në kërkesat tona reale pa realizimin e të cilave nuk do të ketë zhvillim të sektorit hekurudhor.

Orientimi i jonë në vitin 2026 qëndron në:

- ➔ Zhvillimin e planeve tona për një performancës më të mirë të infrastrukturës në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesit;
- ➔ Përmirësimin e dukshëm të angazhimeve tona në arritjen e rezultateve më të mira, duke realizuar kështu synimet tona por me një kosto më të vogël;
- ➔ Angazhim profesional në ngritjen e kompetencës së personelit të mirëmbajtjes së infrastrukturës në përgjithësi;
- ➔ Integrimin e mëtejshëm të programeve të përmirësuar në planet tona të menaxhimit të aseteve;
- ➔ Zhvillimin më të mirë të planeve dhe përkushtimin më të madh të secilit individ për realizimin e traseve të trenit nga operatori hekurudhor;
- ➔ Angazhimet tona të përhershme me partnerët tonë, operatorët hekurudhor, zinxhirin furnizues dhe palët tjera të interesit për realizimin e këtij Plani të Biznesit;
- ➔ Realizimin e suksesshëm të projekteve të rehabilitimit dhe modernizimit për linjën e 10 hekurudhore dhe linjave tjera,
- ➔ Hulumtimi i vazhdueshëm i mundësive të gjetjes së investimeve dhe mundësive të reja të përmirësimit të infrastrukturës.

Ne gjithnjë kemi kërkuar që shteti të ketë një angazhim më të madh në përkrahjen e infrastrukturës hekurudhore, andaj edhe presim nisma të reja në këtë drejtim. Kjo padyshim se do të jetë një nismë e mirë në rimëkëmbjen dhe avancimin për një të ardhme më të mirë të Rrjetit Hekurudhor të Kosovës.

Pse infrastruktura hekurudhore

Kosova është një vend me territor relativisht të vogël, ndërsa infrastruktura rrugore vazhdon të zhvillohet përmes investimeve të vazhdueshme. Në të njëjtën kohë, numri i automjeteve që qarkullojnë në rrjetin rrugor është në rritje, duke ushtruar presion të konsiderueshëm mbi infrastrukturën ekzistuese. Intensiteti i lartë i qarkullimit, veçanërisht i automjeteve transportuese të mallrave, ndikon në rritjen e ngarkesës së trafikut, uljen e nivelit të sigurisë në komunikacion, rritjen e emetimeve ndotëse dhe përshpejtimin e degradimit të infrastrukturës rrugore, sidomos si pasojë e automjeteve me mbingarkesë.

Në këtë kontekst, transporti hekurudhor paraqet një alternativë strategjike për zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të transportit. Rrjeti hekurudhor i Kosovës, me përjashtim të qyteteve të Gjakovës dhe Gjilanit, lidh shumicën e qendrave kryesore urbane të vendit, duke krijuar potencial të konsiderueshëm për transferimin e një pjese të transportit të udhëtarëve dhe mallrave nga rruga në hekurudhë. Një orientim i tillë do të kontribuonte në uljen e ngarkesës së trafikut rrugor, reduktimin e aksidenteve, zvogëlimin e kostove të mirëmbajtjes së rrugëve, si dhe në përmirësimin e cilësisë së mjedisit.

Infrastruktura hekurudhore ofron kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e transportit të udhëtarëve dhe mallrave, duke siguruar efikasitet më të lartë operacional, kosto më konkurruese, nivel më të lartë të sigurisë, besueshmëri në realizimin e shërbimeve dhe ndikim dukshëm më të ulët në mjedis krahasuar me transportin rrugor.

Zhvillimi i sektorit hekurudhor është një ndër prioritetet strategjike të Bashkimit Evropian dhe po fiton rëndësi të veçantë edhe në vendet e rajonit, si pjesë e politikave për zhvillimin e transportit të qëndrueshëm dhe integrimin e rrjeteve ndërkombëtare të transportit. Në këtë drejtim, zhvillimi dhe modernizimi i rrjetit hekurudhor të Kosovës përbën një element të rëndësishëm për rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike, përmirësimin e lidhshmërisë rajonale dhe avancimin e procesit të integritetit në rrjetin evropian të transportit.

Një zhvillim i rëndësishëm në këtë sektor është investimet e konsiderueshme në infrastrukturën hekurudhore. Mbështetja financiare e ofruar nga Bashkimi Evropian, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI) për rehabilitimin e përgjithshëm të Linjës Hekurudhore 10 (Leshak – Mitrovicë – Fushë Kosovë – Hani i Elezit), si dhe financimi nga Qeveria i projektimit preliminar për rehabilitimin dhe modernizimin e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Klinë – Pejë dhe Klinë – Prizren, përfaqësojnë qasje për investime strategjike për sektorin. Këto projekte krijojnë bazën për modernizimin e mëtijshëm të rrjetit hekurudhor, rritjen e cilësisë së shërbimeve, integrimin me rrjetin rajonal dhe atë të Bashkimit Evropian, si dhe për forcimin e rolit të hekurudhës si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe të transportit të qëndrueshëm në Kosovë.

----- Fundi i Dokumentit -----